



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
REKTORATI

Nr. 1252 prot

Durrës, më 27.9.2021

**VENDIM**

Nr. 12, datë 27.9. 2021.

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 685 datë 25.08.2010 "Për riorganizimin e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës", të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", të Urdhërit nr 413, datë 24.09.2021 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale", të Statutit të Universitetit, të Rregullores së Universitetit, Rektorati në mbledhjen e tij të datës 27.09.2021,

**VENDOSI:**

1. Ngarkimin e dekanëve të fakulteteve, në marrjen e masave për fillimin e vitit të ri akademik dhe zhvillimin e mësimin në auditor.
2. Ngarkimin e dekanëve të fakulteteve për nxjerrjen e publikimin e listave të studentëve fitues dhe të transferimeve, si edhe hedhjen e tyre në faqen web të UAMD.
3. Ngarkimin e dekanëve të fakulteteve për organizimin e orarit për ciklin e parë të studimeve, për vitin akademik 2021-2022.
4. Ngarkimin e dekanëve të fakulteteve, për përmbushjen e procedurave për rekrutimin e stafit akademik me kohë të pjesëshme dhe kohë të plotë.
5. Ngarkimin e dekanëve të fakulteteve, në marrjen e masave anti covid në fillim të vitit të ri akademik në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit e Sporteve dhe Ministrisë së Shëndetësisë, si edhe për ngritjen e strukturave përkatëse në funksion të përmbushjes së kërkesave mbi vaksinimin e stafit akademik dhe studentëve dhe paraqitjes së analizave (tampon) në rast të mos vaksinimit.
6. Ngarkimi e dekanëve të fakulteteve për të garantuar mësim online për studentët e pavaksinuar.
7. Ngarkimin e Administratorit të Universitetit në marrjen e masave për të garantuar bashkëpunimin me Institutin e Shëndetësisë në funksion të ngritje së qendrave të vaksinimit në të dy godinat e Universitetit.

8. Ngarkimin e Zv. Rektores Prof.As.Dr.Eva Teqja, për hartimin e Strategjisë së komunikimit dhe Rregullores së mirmbajtjes së faqeve web të fakulteteve në UAMD, si dhe trajnimin e koordinatorëve të komunikimit me përfaqësuesit e çdo fakulteti.
9. Ngarkimin e dekanëve të fakulteteve, për marrjen e masave në rritjen e angazhimit të sekretarive në funksion të një standarti të ri komunikimi dhe shërbimi për studentët.
10. Ngarkimin e dekanëve të fakulteteve në marrjen e masave për ngritjen e grupeve koordinuese në funksion të procesit të adredimit të UAMD-së.
11. Ngarkimin e Zv. Rektores Prof.As.Dr.Eva Teqja, në bashkëpunim me dekanët e fakulteteve për konsultimin e guidës studentore, dhe përcjelljen e mendimeve, lidhur me përmirësimin e mëtejshëm të saj.
12. Ngarkimin e dekanëve të fakulteteve, në marrjen e masave për organizimin e javës së orientimit të studentëve në këtë fillim të vitit të ri akademik 2021-2022.
13. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi:
  - Zv. Rektorët
  - Administratori
  - Dekanët e fakulteteve
  - Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Juridike.
14. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

  
Prof. Dr. Ksanela SOTIROFSKI